

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Eurodeputetja i kërkon qeverisë që të mos zvarrisë ndryshimet në ligjin 21/2024 - Reporter.al
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/23/eurodeputetja-i-kerkon-qeverise-qe-te-mos-zvarrise-ndryshimet-ne-ligjin-21-2024/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:53:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 12:26:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4ac07bc809d7bf2fcf579d2106d85bcb287cca17702edd5664dc168d4fe96fdd
TEKSTI	fe98f9303b3e51529c97e27aabe99a7d19399bb5a2f9fc80f4e51865c04fcc8d
PAMJA	a5d75f8680849e8c82ce8ef0a6f7bf8f940a6427c120ddd27cbfd733956e2da2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	166352f8de8e41cea4722dec6c9a28f970f598f5baf6a72a49a801bf0320c0dc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/166352f8de8e41cea4722dec6c9a28f970f598f5baf6a72a49a801bf0320c0dc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Lajme

Eurodeputetja i kërkon qeverisë që të mos zvarrisë ndryshimet në ligjin 21/2024

Eurodeputetja Terry Reintke paralajmëroi nga Tirana qeverinë shqiptare kundër zvarritjes së rishikimit të ligjit për Zonat e Mbrojtura. Ajo kërkoj një moratorium të menjëhershëm për projektet në bregdet, ndërsa mazhoranca mbron standardet e investimeve.

nga Vladimir Karaj — 2 hours më parë në Lajme Koha e leximit: 2 min lexim

AA 0



Bashkëkryetaria e grupit të të Gjelbërve (Greens/EFA) në Parlamentin Evropian, Terry Reintke gjatë konferencës për shtyp. Foto: BIRN.

Bashkëkryetaria e grupit të të Gjelbërve (Greens/EFA) në Parlamentin Evropian, Terry Reintke, i kërkoj qeverisë shqiptare nga Tirana të mërkurën që të mos zvarrisë rishikimin e amendamenteve ligjore për Zonat e Mbrojtura dhe vendosjen e menjëhershme të një moratoriumi për projektet e debatuar në bregdet.

Duke iu referuar posaçërisht vonesave nga Parlamenti i Shqipërisë në rishikimin e ligjit 21/2024 për zonat e mbrojtura, një nga kërkesat e protestës së vazhdueshme qytetare të filluar në fund të majit, eurodeputetja ishte e prerë.

"Të zvarrisësh këmbët dhe të përpiqesh ta lësh të gjithë çështjen të zbehet e më pas të fillosh ndërtimin pa ndryshuar ligjin, ky nuk është një opsion nga këndvështrimi im," tha Reintke.

Gjatë komunikimit me gazetarët, Reintke theksoi se vendimi i marrë nga Parlamenti Evropian në fillim të verës mbetet në fuqi, pavarësisht vizitave në terren të zhvilluara nga palë të tjera.

"Ne mbajmë një qëndrim në qershor dhe ai nuk ka ndryshuar. Dhe ky pozicion është të kemi një moratorium për këto projekte dhe të rishikojmë amendamentet që qartësisht nuk janë në linjë me ligjin e BE-së," theksoi ajo.

Reintke iu referua edhe rezolutës së miratuar nga Parlamenti Evropian, pas fillimit të protestave të pagëzuara si "Revolucioni i Flamingove", kundër projektit turistik në Zvërnec, i miratuar nga qeveria në bazë të ndryshimeve të reja ligjore të bëra në mënyrë të njëanshme dhe pa konsultim në vitin 2024. Reintke kujtoi se PE i ka kërkuar qeverisë shqiptare të vendosë menjëherë një moratorium për procedurat e reja të lejeve, punimet e ndërtimit dhe ndërhyrjet zhvillimore në zonat e mbrojtura, deri në shfuqizimin e dispozitave të papajtueshme të ligjit të ndryshuar për zonat e mbrojtura.

Megjithatë, që nga miratimi i rezolutës në qershor, qeveria shqiptare dhe mazhoranca parlamentare nuk kanë ndërmarrë asnjë hap konkret për shfuqizimin e dispozitave që u hapën rrugën ndërtimeve masive turistike në zonat bregdetare, mes tyre dhe projektit të Zvërnecit.

Kuvendi injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale

16:11 | 23/09/2026

Avokati i Netanyahu-t mes drejtuesve të kompanisë që prodhon dronë izraelitë në Serbi

15:08 | 23/09/2026

Eurodeputetja i kërkon qeverisë që të mos zvarrisë ndryshimet në ligjin 21/2024

14:26 | 23/09/2026

A mund të ndjekim Hungarinë në hetimin e pasurive të zyrtarëve?

12:20 | 23/09/2026

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

06:20 | 23/09/2026

Rama shkarkon Hysenin, por shmang përgjegjësitë për skandalin në SHISH

16:31 | 22/09/2026

Ajo u pyet posaçërisht mbi faktin se vizita e saj në shesh krah protestuesve ishte në kontrast të plotë me axhendën e disa kolegëve të saj eurodeputetë, të cilët shoqëroheshin nga përfaqësues të shumicës parlamentare në një vizitë të ngjashme. Për këtë Reintke tha se do të ketë ballafaqime në institucionet evropiane dhe koordinim me kolegët që patën një axhendë të ndryshme.

“Ajo që do të bëj tani me t’u rikthyer në Bruksel është të kontaktoj dhe të diskutoj me ta. Të kesh këtë lloj shkëmbimi se çfarë duhet të ndodhë nga një nivel evropian në mënyrë që gjërat të ecin përpara,” theksoi ajo.

Ndërkohë, shumica parlamentare këmbënguli edhe të mërkurën në qëndrimin e saj. Kreu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, i cili shoqëroi kolegët e Parlamentit European, paraqiti në një deklaratë të mërkurën një pamje optimiste të projektit, duke lënë të kuptohet se si investimi do të përputhej me kërkesat e PE-së për mjedisin.

“Angazhimet mjedisore për zhvillimin e turizmit në këtë zonë synojnë të përmbushin ose të tejkalojnë kërkesat e Bashkimit European,” tha Balla në Facebook pas vizitës në terren me disa eurodeputetë.

Etiketa: [Ligji 21/2024](#) [Resorti ne Zvërnec](#) [Rezoluta e PE](#) [Terry Reintke](#) [Zonat e Mbrojtura](#)

Reporter.al

[Opinion](#)
[Reportazhe](#)
[Analiza](#)
[Investigime](#)
[Lajme](#)
[Blog](#)
[Rajoni](#)

[Rreth nesh](#)
[Stafi](#)
[Kontaktimi](#)
[Ankesa dhe Korrigjime](#)
[Politika e privatësisë dhe rregulla të tjera](#)
[Letra për redaktorin](#)

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by [Slida.PRO](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.